



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në Rahovec, e mbajtur më 09.12.2020 me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

**Kryetari**- Më lejoni t'i përvihendës të gjithë të gjithë anëtarët e KKS, Nënkyetarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtoret e Drejtoreve, komandantin e stacionit të policisë në Rahovecit z. Fazli Morina, Përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezent këtu që përfaqësojnë nga pikëpamja e sigurisë që kontribuojnë në komunën e Rahovecit, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përparrë e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2020 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës. Ky është takimi i gjashtë dhe i fundit për vitin 2020 për vitin 2019 i KKS-së. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë për periudhën tetor – nëntor, rreth menaxhimit të situatës së krijuar nga Covid – 19;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit;
  - Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike,
  - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
  - Mungesa e parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKS-së për vitin 2021;
5. Të ndryshme

### 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në votim.

Konsistojë se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

### 2. Informatë rreth menaxhimit të situatës të krijuar nga Covid – 19 nga Komuna e Rahovecit.

**Kryetari** – Përvihendetje për të gjithë të pranishmit në sallë, të nderuar sa i përket menaxhimit të situatës me Covid – 19, ne si komunë i kemi të gjitha të dhënat që nga fillimi i kësaj pandemie e deri në ditën e stome, IKSHPK-ja sapo më lajmëroi sot komuna janë nuk ka asnjë rast dhe ky është një lajm i mirë. Do ju japë disa informata ose disa shifra: komuna e Rahovecit për momentin i ka 287 të shëruar, 110 raste aktive dhe 445 vdekje, pra gjithsej janë 442 raste këto janë të dhëna që nga fillimi e deri dje. Vazhdon dezinfektimi i objekteve të institucioneve dhe mjediset publike ku janë më të frekuentuara. Ne si komunë deri diku jemi duke e përballuar mirë

situatën edhe pse i kemi dikur rreth 14 mjek të prekur me Covid-19, po ashtu edhe gjendja në arsim është e mirë, ka qenë një nxënës dhe disa mësimdhënës të prekur me Covid – 19, por gjithçka ka shkuar mirë. Mjetet për mbrojtje nga Covid -19 kemi të mjaftueshme, shkollat janë të pajisura me maska dhe dezinfektues, si përfundim shpresojmë se gjendja me Covid -19 të përmirësohet dhe ne do i kthehem normalitetit sepse shumë biznese janë dëmtuar.

**Nysret Abazibra** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha vetëm të kyqem dhe të jap një informatë shtesë sa i përket vdekshmërisë në komunën tonë, nëse e krahasojmë vitin e kaluar me këtë vit, ne si institucion i Bashkësisë Islame në Rahovec konsiderojmë që është një dallim shumë i madh nëse e krahasojmë me vitet e kaluara, ajo që dua të them është se rastet e konstatuara në formë zyrtare ndoshta nuk janë të sakta në krasim me realitetin. Ne në vitin 2019 kemi pasur 315 raste të vdekjes, kurse në vitin 2020 deri me datën e sodit kemi 471 raste, ndërsa vetëm në muajin që jemi tani dhjetor për 9 ditë kemi 22 raste, pastaj muaji nëntor kemi pasur 65 raste që kur më parë nuk ka pasur kaq shumë raste. Kjo tregon se gjendja me Covid – 19 është shumë më serioze se sa ne e evidentojmë. Ajo që ne e kemi vërejtur është se njerëzit hezitojnë të tregojnë se i afërmë ose ata janë me covid – 19, këtë ne jemi duke e vërejtur kur njerëzit vinë ta lajmërojnë rastin dhe kjo mendoj se është një dobësi shumë serioze, nuk është turp që njeri të infektohet nga Covid -19. Kjo duhet të luftohet si shoqëri se nëse nuk e luftojmë atëherë kjo do të na shkaktoj edhe më shumë probleme.

**Kryetari** – I nderuari z. Abazibra ju kisha lutar që të jeni në kontakt me drejtorin e shëndetësisë z. Samir Mustafa sepse këta e kanë edhe obligim që ato raste që janë me Covid-19, flas ato zyrtare që edhe shërbimi i varrimit dhe shërbime të tjera të kryhen me një procedura tjetër në mënyrë që të jemi më të kujdeshshëm. E them këtë sepse nganjëherë nuk po kemi dallime në varrimin e qytetarëve që janë duke vdekur nga Covid – 19 dhe ata që kanë vdekur në rrethana të tjera, dhe si pasojë e kësaj mundemi të kemi pastaj edhe infektimin e qytetarëve të tjerë Ju faleminderit fjalën ja japë komandantit të stacionit policor.

**Fazli Morina**, komandanti i policisë në Rahovec – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, së pari desha të kyçem sa i përket ceremonive mortore sepse barra kryesore na bie neve si stacion policor dhe ne pastaj po mbesim në pozita më të palakmueshme që mundet të ekzistoj një njeri. Të nderuar qoftë varrimet të konfirmuara me Covid – 19, qoftë vdekjet natyrale masat duhet të ndërmerren si për të dyja rastet, ne si patrullë e policisë gjithmonë jemi aty kur ka varrime, por është një pozitë e keqe sepse është vdekje ka dhimbje dhe nuk kemi si të ndërhyrë, por nuk është ashtu siç e shkruajnë se është varrosur në prezencën e 20 familjarëve sepse shumë më shumë njerëz marrin pjesë deri në 300. Prandaj ju lusë të gjithëve që jeni sot këtu pjesëmarrës në këtë mbledhje të diskutoni me të afërmët e juaj dhe aty ku mundeni që t'i njoftoni me vendimet dhe procedurat të cilat janë anti Covid – 19, në mënyrë që mos të kemi më shumë raste, ne si polici në ato raste jo që nuk mundemi të reagojmë por moralisht nuk po mundemi të marrim masa gjata varrimit të një të afërmë.

**Kryetari** – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e zhvilluar në pikën e parë të rendit të ditës, kalojmë tanit në pikën e radhës:

### 3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovëcit.

**Kryetari** - Sa i përket kësaj pike gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile, po e përsërisë se nuk kemi ndonjë rast i cili do e shqetësoj komunën tonë, pra vazhdon që komuna jonë të jetë e qetë, unë si kryetar komune pranoj çdo ditë raporte nga polica e Rahovëcit, po ashtu kemi kontakte të vazhdueshme dhe për këtë e falënderoj edhe policin e Kosovës stacioni në Rahovec. Jo që ja vlen ndoshta të ceket është se jemi duke vazhduar që të sfidohemi nga hajnat, kemi pasur disa vjedhje dhe plaçkitje në disa lokalitete dhe në qytet,,, por për këtë na informon më mirë komandanti i policisë. Kurse sa i përket nënpikave, mendoj se parkingje në Rahovec ka mjaftueshëm por sa janë duke u shfrytëzuar ajo është diçka tjetër, kurse sa i përket ndriçimit publik, me lejoni që të ju them se ndriçimi publik është duke vazhduar të ritet çdo ditë, ne kemi kontratë dhe jemi duke vazhduar nga fshati në fshat, ju siguroj se asnje fshat dhe asnje lagje nuk do të jetë pa ndriçim

publik. Sa i përket monitorimit të arsimit të gjithë e dini se si zhvillohet mësimi tanë në komunën tonë por edhe në gjithë Kosovën, ne e kemi pranuar një udhëzues se si duhet të i zhvillojmë mësimet, poashtu e kemi edhe task forcën e DKA-së dhe task forcat e shkollave. Vlerësimet në shkolla janë në baza ditore, neve na informojë se si shkon situata nëpër shkolla. Kurse sa i përket vetëdipesimit të qytetarëve për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknicke, ne duhet të përgatitemi sepse viti ri po vije, fishekzjarret vetëm sa kanë filluar të hidhen, e mira kishte me qenë që të ndërprenhet në burim këto gjera, por kjo nuk varet nga ne, mirë kishte me qenë që të ndalen së paku ato që janë më të rrezikshme.

**Fazli Morina** – Të nderuar sa i përket situatës së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit, vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, policia e Kosovës me përkushtim dhe profesionalizëm garanton rend publik, qetësi dhe siguri për të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit. Kurse sa i përket menaxhimit të situatës së pandemisë Covid – 19, në zonën tonë të përgjegjësisë gjatë periudhës raportuese, të gjitha njësítë e kanë qenë të angazhuara në drejtim të implementimit të Planit operativ të DRP-së Gjakovë, për gatishmëri dhe reagim për Corona virus Covid – 19, si dhe kanë vepruar në përputhje me zhvillimet aktuale dhe zbatimin e vendimeve të qeverisë së Kosovës. Poashtu patrullat e stacionit të policisë në Rahovec në vazhdimësi kanë bërë asistimin e inspektorëve komunal dhe atyre qendror të sanitarisë duke bashkëvepruar në teren, ku bashkërisht kanë ndërmarrë masa adekuate sipas ligjit anti Covid – 19, për menaxhimin e situatës së pandemisë Covid – 19. Sa i përket masave anti Covid – 19 janë shqiptuar rreth 1220 tiketa në shumën prej 35 €, në bazë të ligjit Nr.07/L-066, për parandalimin dhe lufitimin e pandemisë Covid – 19. Por nëse i referohemi periudhës raportuese që nga hyrja në fuqi e këtij ligji nga 14 gushti e deri me 30 nëntor 2020, janë shënuar gjithsej: 1460 gjoba anti Covid – 19, pastaj 1436 për mos vendosjen e maskës mbrojtëse, 2 për mos mbajtje të distancës, 2 për mos respektim të orarit, 7 për tubime dhe aktivitete të ndaluara, 1 për mos respektimin e masave për vet izolim, 35 raste penale për mosveprim ndaj dispozitave shëndetësore dhe 1065 fletëkërkesa ose fletëparaqitje personave të cilat nuk kanë respektuar vendimet e qeverisë, më pas janë dërguar inspektorëve sanitari për ti proceduar në gjykata. Nëse bazohemi në situatën aktuale e cila është në teren, besoni se këto janë shumë pak dënimë. Ndërsa rastet penale gjatë kësaj periudhe raportuese janë: 117 raste, prej tyre 115 vepra penale dhe 2 incidente të ndryshme. Nga këto mund të veçojmë disa vepra më të rënda: Vjedhje 18 raste, vjedhje të rëndë 21 raste, mbajtje në pronës të pa autorizuar të armeve 3 raste, dhuna në familje 9 raste. Lidhur me rastet e cekura në kuadër të stacionit policor në Rahovec dhe hetimeve rajonale në Gjakovë, janë ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme operacionale dhe hetimore.

Siguria në trafik, situata në komunikacionin rrugor në qytetin e Rahovecit, për shkak të punimeve në rrugën kryesore Xhelal Hajda – Toni, në segmentin rrugor tek stacioni i autobusëve deri tek pompa e deriveve Veda Petroll, është bërë devijimi i rrugës në rrugën Gëzim Hamza – Piktori dhe Ibrahim Rugova, ku rrjedha e komunikacionit rrugor zhvillohet me vështirësi të dukshme, e kjo është si shkak i gjerësisë së pamjaftueshme të dy rrugëve, më pastaj edhe qarkullimi i mjeteve të rënda. Andaj, edhe çështja e parkimit të veturave në trotuare është një dukuri shqetësuese për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun urban. Mungesa e parkingjeve publike, infrastrukturës, mungesë e trotuareve disa pjesë të rrugëve të qytetit, mungesa e vetëdijes nga ngasësit dhe bizneseve të ndryshme që veprojnë në qytet, dukuria e bllokimit të trotuareve është shqetësuese dhe paraqesin rrezik për të gjithë pjesëmarrësit në trafik e në veçanti personat me nevoja të veçanta. Policia e Kosovës në vazhdimësi ndërmerr masat e nevojshme ligjore ndaj kundërvajtësve të papërgjegjshëm, me qëllim që të ju mundësohet lëvizja e lirë të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion, posaçërisht të kategorive më të rrezikuara të cekura më lartë.

Siguria në shkolla, policia e Kosovës në vazhdimësi është përkushtuar lidhur me sigurinë në objektet shkollore, ku gjatë periudhës raportuese, ka vazhduar implementimin e Planit Operativ “Siguria në Shkolla”, duke bërë vizita në shkolla dhe kontakte me kuadrin arsimor, duke

angazhuar edhe zyrtar policor me rroba civile. Gjatë periudhës raportuese është regjistruar një rast Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë në SHDMU "Hamëz Thaqi" në Xërxe, ku nga persona të njojur për ne janë thyer tre xama të dritareve të shkollës. Rasti është zbuluar dhe është mbyllur me kryes të njojur, të mitur. Po ashtu, janë iniciuar tri raste penale me lëndime trupore dhe Prishja e Rendit dhe Qetësisë publike, ku janë të përfshirë nxënësit e shkollës së mesme "Xhelal Hajda - Toni" dhe nxënësit e shkollës profesionale "Selajdin Mullabazi - Mici". Po ashtu ka qenë edhe një rast mu para shkollës së mesme "Xhelal Hajda - Toni", ka qenë edhe një incident ku janë përfshirë një grup i madh nxënësish, por si rast nuk është raportuar në polici.

Kryetari - Faleminderit i nderuari komandant për këtë informatë, a ka dikush edhe diçka të shtojë sa i përket kësaj pike nëse jo atëherë kalojmë në pikën e radhës:

#### **4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSBS-së për vitin 2021.**

Kryetari - Të nderuar ky plan ka qenë në diskutim publik në web faqe të Komunës, ku të gjithë të interesuarit kanë pasur të drejtë që të japid propozimet dhe mendimet e tyre sa i përket planit të punës së KKSBS-së për vitin 2021, por sipas z. Skender Hamza, udhëheqëse për Punë të Kuvendit dhe koordinator i KKSBS-së, deri më tani nuk ka ardhur asnjë email në adresë të tij sa i përket këtij plani. Prandaj nga ju kërkohet që ky plan të aprovohet ku pastaj do të aprovohet edhe në mbledhje të kuvendit. Plani është aprovuar në mënyrë unanime nga anëtarët e KKSBS-së. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar Plani i Punës së KKSBS-së për vitin 2021. Kalojmë në pikën e fundit.

#### **5. Të ndryshme.**

Të nderuar a keni diçka të shton si i përket kësaj pike, nëse jo atëherë më lejoni që të ju urojë festat e fund vitit, shpresoj se viti ardhshëm do jetë një vite i mbarë për të gjithë ne, po ashtu shpresoj se nuk do të përballemi më me pandeminë Covid – 19, mirë u takofshim.

Procesmbajtësi

Agim Hoti

Kryetar i Komunës

Smajl Latifi

